



Në bazë të nenit 8, 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, dhe kërkesës Nr.02/13452 data: 15/04/2024, nga Zyra Lokale për Komunitete, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Zyra Lokale për Komunitete

Titulli i pozitës: **Zyrtar/e për Integrim të Komuniteteve**

Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Orar i punës : 40 në javë

Paga bruto mujore: 360 €.

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

Detyrat Kryesore:

- Ndihmon dhe bashkepunon me kryetarin e komunës dhe shefin e ZLK- së ne funksionimin e rregullte te strukture ekzistuese per kthim.
- Merr pjese ne mbledhjet e komisioneve ekzistuese si dhe ne forume te tjera ne te cilen çeshtja e kthimit eshte pjese e rendit te dites.
- Lehteson angazhimet komunale ne aktivitete rreth kthimit ne nivelin komunal dhe I levize ato aktivitete perpara duke punuar ne drejtim te sigurimit qe drejtorit komunale ti perkushtojne burimet ne zhvillimin, zbatimin dhe percjellje te projekteve per perkrahjen e kthimeve te qendrueshme apo per krijimin e kushteve per kthim.
- Bene nderlidhjen ne mes te paleve kryesore me interes ne procesin e kthimeve, duke perfshire perfaqesuseit e personave te kthyer, perfaqesuesve te komuniteteve dhe institucioneve dhe OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare.
- Percjelle projekte per kthim dhe I raporton kryetarit dhe drejtorit per perparimet e arritura.
- Perpilon Strategjine komunale per kthim te qendrueshem, e cila sherben si kornize per aktivitete te Grupit punues komunal per kthim gjate vitit.

Kualifikimi:

Shkolla e mesme, përvoja e punës e dëshirueshme

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon:

Dëshmi të kualifikimit shkollor

Dëshmi mbi përvojën e punës,

Dokumentin e identifikimit.

Aplikacionet merren dhe të plotësuar dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është 8 ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale”.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kritereve të shpalljes Publike, njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Kryetar i Komunës së Kamenicës

Kadri RAHIMAJ

		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh.	02	Nr.	14123
U.		Br.	
Nr. i faq.	1	Data:	30/04
Br. str.		Datum:	2024
KAMENICË/A			